



Prishtinë, 13 prill 2017  
Kodi i ZRRE-së: V\_91?\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 5 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Dispozitat e Neneve 5 dhe 7 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji,
- Dispozitat e Nenit 10 të Parimeve për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut si dhe taksave të kyçjes,
- Kodin e Rrjetit – Kodin e Kyçjes, dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 10.03.2017 për shqyrtimin dhe aprovimin e dokumentit “Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit”

në seancën e mbajtur me datë 13.04.2017 nxori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet “Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit” e KOSTT-it**

### A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 10.03.2017 ka pranuar kërkesën e KOSTT për amandamentimin e Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit. Në këtë kuadër janë bërë përshtatje të dispozitave ligjore dhe rregullative me legjislacionin e ri, shtesa dhe qartësime, riformulime të fjalive. Dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e KOSTT për diskutim publik.
- o ZRRE ka dhënë komente në draft dokumentin e Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, ndërsa nuk ka pasur komente tjera nga palët e interesit.
- o Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.



- Pas vlerësimit të dokumentit, ZRRE ka aprovuar amandamentimin e Metodologjisë së Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit.
  - Të gjitha dispozitat tjera të Metodologjisë së Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit do të mbesin në fuqi.
- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Shtojcë: **Metodologjia e Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit** i amandamentuar.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

**Bordi i ZRRE-së**

  
Krenar Bujupi, u.d. kryesuesit

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfi, anëtar